



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 17 datë 25.3.2021

**“PËR NJË SHTESE NË VKB NR. 63 , DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2021-2023 TË BASHKISË SHKODËR“**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 25.3.2021 , zhvilluar online, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetje të ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 54 germa “dh” ; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; të ligjit nr. 137/2020 date 16.12.2020 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2021; ligji 68/2017 dt.27.04.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore ; ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar ; VKM nr. 1149 datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 175 dt. 08.03.2017 të KM “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi Plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”VKB nr. 63 , datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër“ ; Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2987, datë 11.02.2021 me objekt “Dërgohet fondi i rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor”, relacionit të administratës së bashkisë Shkodër bashkelidhur, relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratoje një shtesë në VKB nr. 63 , datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të bashkisë Shkodër“, në programin 9120 “Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor “ nga zëri transferime korente të brendshme (604) ne shumen 10 736 234 leke te zërin paga

(600) dhe sigurime shoqerore (601) per rritjen e pagave per funksionin e arsimit parashkollor dhe Qendren Kulturore te Femijeve, stafi mesimor, si me poshte:

Programi 9120 – Arsimi baze perfshire dhe parashkollor (shtese)

ne leke

Nr	Programi	Institucioni	Aktiviteti/Emërtimi	Shpenzime për paga /Artikulli 600	Shpenzime për sigurime shoqërore /Artikulli 601	Totali
1	Pr. 09120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve	P 09120.O1 .A1. Mbështetja për punonjësit e arsimit bazë.	8,828,882	1,404,213	10,233,095
2	Pr. 09120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	P 09120.O1 .A10. Mbështetja e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor	434,097	69,042	503,139
TOTALI				9,262,979	1,473,255	10,736,234

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lasha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 26.3.2021